

## Procesverbal

**Konsultim publik :** *Me Banorët e Njesisë Administrative Qytet, Qënder*

**Data :** 12/12/2025

**Ora :** 10:00

**Vendi:** Pallati kultures Tepelene

**Numri i pjesëmarrësve :** Gjithësej 77 persona të pranishëm. (23 gra dhe 54 burra).

**1.Titulli i Projekt – aktit që konsultohet:** Projekt draft programit buxhetor afatmesem 2025-2027, paketa fiskale dhe projekt buxhetin e vitit 2025.

**2. Pjesëmarrës :**

1. Gramos Sako (Kryetar i Bashkisë)
2. Spiro Kora (N/Kryetar)
3. Julinda Karteri (N/Kryetar)
4. Valbona Cela (Sekretare Këshilli)
5. Arben Gumeni (Kryetar i Këshillit)
6. Ela Skenderaj (Koordinatori informimit)
7. Arta Shaha (Drejtoare Arsim - Kulturës)
8. Gezim Shehu (Drejtori Zhvillimi Rural)
9. Ervin Panidha (DPKZHT)
10. Adi Vela (DSHP)
11. Esmeralda Bishani (Anëtare Keshilli)
12. Vladimir Bakiaj (Anëtar Këshilli)
13. Besnik Maca (Anëtar Këshilli)
14. Aleksandër Toti (Kabineti Kryetarit)

**Kryetari i Këshillit, z. Arben Gumeni:**

Hap dëgjuesën publike dhe falënderon të pranishmit për pjesëmarrjen në këtë takim konsultues për PBA 2026–2028 dhe projektbuxhetin 2026. Ky proces ka rëndësi të veçantë, sepse përfshin komunitetin në vendimmarrje dhe garanton transparencë në

planifikimin e investimeve. Sot ju ftoj të jepni mendimet, sugjerimet dhe nevojat e komunitetit, në mënyrë që ky buxhet të reflektojë sa më mirë prioritetet tuaja.

**Kryetari i Bashkisë, z. Gramos Sako:**

Përshëndetje të gjithëve. Jemi mbledhur sot në këtë dëgjese publike për Planin e Buxhetimit Afatmesëm 2026–2028, projektbuxhetin e vitit 2026 dhe paketën fiskale 2026. Kjo dëgjese ka për qëllim informimin, konsultimin dhe marrjen e mendimeve tuaja, në mënyrë që dokumentet buxhetore të pasqyrojnë sa më mirë nevojat dhe prioritetet e komunitetit.

**Qëllimi i dëgjesës publike**

Dëgjesa publike organizohet në kuadër të procesit të konsultimit me komunitetin, sipas ligjit për vetëqeverisjen vendore dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave, me synim:

- Të informojë qytetarët mbi Paketën Fiskale 2026;
- Të paraqesë projektbuxhetin e vitit 2026;
- Të marrë mendimet, sugjerimet dhe propozimet e komunitetit;
- Të rrisë transparencën dhe llogaridhënien në administrimin e fondeve publike.

**Paketa Fiskale 2026**

Për vitin fiskal 2026 nuk parashikohen ndryshime të mëdha në paketën fiskale të Bashkisë Tepelenë. Tatimet dhe tarifat vendore do të mbeten kryesisht të njëjta me vitin e kaluar.

**Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet si vijon :**

- **Administratori i Njesisë Qendër Z. Leonidha Shumeli ;**

Hartimi i projektbuxhetit 2026–2028 është një moment i rëndësishëm jo vetëm për Njësine Administrative Qendër, por për gjithë Bashkinë Tepelenë. Një nga shtyllat kryesore për garantimin e shërbimeve cilësore është parashikimi i saktë i të ardhurave, pasi çdo fshat ka planin e vet të të ardhurave, të cilat rikthehen në formën e shërbimeve dhe investimeve për komunitetin.

Njësia Administrative Qendër parashikon rreth 8.7 milion lekë, dhe vit pas viti janë realizuar rreth **101%** e të ardhurave. Aktualisht, shërbimet bazë si ndriçimi, pastrimi dhe mirëmbajtja e kanaleve ujitëse janë në nivele të kënaqshme. Investimet që mbeten prioritet për t'u adresuar përfshijnë:

- rehabilitimin e rrugëve të paasfaltuara,

- përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit dhe qendrave të fshatrave,
- hapjen dhe pastrimin e lerave,
- zgjerimin e sistemit të ndriçimit në fshatra, i cili po kalon në një etapë të re me instalimin e paneleve diellore.

## **Problematikat dhe objektivat sipas fshatrave**

### **Fshati Hormovë**

- Pastrimi i përroit të Gurrës.
- Shtrimi me beton i rreth 400 metrave në lagjen e poshtme.
- Përmirësime asfaltike të rrugës.
- Ndërhyrje për furnizimin me ujë të pijshëm në lagjen e sipërme dhe lagjen e poshtme.

### **Fshati Lekël**

- Shtrim me beton në lagjen e poshtme dhe lagjen Cikuri (rreth 200 m).
- Pastrim i lerave dhe krijimi i lerave të reja.
- Kanal vaditës Kodër – Fushë Lekël (1.5 km).

### **Fshati Kodër**

- Shtrim me beton (350 ml).
- Hapje dhe rehabilitim i kanalit vaditës.

### **Fshati Peshtan**

- Ndërhyrje në përrua për parandalimin e dëmtimeve.
- Rehabilitim i çezmës së fshatit.
- Shtrim rruge (300 ml).
- Ndërtim i ujësjellësit.

### **Fshati Mezhgoran**

- Asfaltim i rrugës.
- Shtrim dhe sistemim i rrugëve të brendshme.

### **Fshati Dragot**

- Ndërhyrje në qendrën e fshatit.
- Shtrim me beton drejt kalasë (200 m).
- Rehabilitim dhe pastrim i kanaleve kulluese.

### **Fshati Beçisht**

- Përmirësim i shtresës asfaltike të rrugës.

- Shtrim me beton (250 ml).
- Riparim i çezmës së fshatit.

#### **Fshati Luzat**

- Shtrim i rrugëve të brendshme në gjithë fshatin (350 m).
- Ndërtim i qendrës së fshatit.
- Ndërtim i ujësjellësit të fshatit.

#### **Fshati Benç**

- Sistemim i rrugëve të brendshme (150 ml).
- Hapje rruge drejt parcelave bujqësore.

#### **Fshati Veliqot**

- Shtrim me beton në lagjen e poshtme dhe lagjen e sipërme (350 m).
- Mirëmbajtje e qendrës së fshatit.
- Sistemim i rrugës drejt parcelave bujqësore.

#### **Fshati Turan**

- Ndërhyrje në qendrën e fshatit.
- Shtrim rruge me beton (300 ml).
- Ndërtim i ujësjellësit.
- Rrethim i varrezave të fshatit.
- Ndërtim i një lere të re dhe pastrim i lerës ekzistuese.

#### **Fshati Dukaj**

- Shtrim i rrugëve në vazhdimësi.
- Pastrim i lerave.
- Ndërhyrje në rrugën Dukaj–Kordhaj.
- Asfaltim i rrugës Kordhaj–Memaliaj.
- Ndërhyrje në ujësjellësin e Kordhajit.
- Sistemim i përroit të Kordhajit.

#### **Fshati Salari**

- Ndërhyrje në qendrën e fshatit.
- Rrethim i varrezave.
- Shtrim i rrugëve të brendshme (500 m).
- Pastrim dhe mirëmbajtje e lerave.

#### **Fshati Mamaj**

- Shtrim me beton (200 ml).
- Sistemim i qendrës së fshatit.
- Ndërtim emergjent i ujësjellësit të fshatit.

### **Objektiva të përgjithshme për të gjitha fshatrat**

- Pikë-lidhje e energjisë elektrike, dhe ujit të pijshëm në të gjitha ambulancat.
- Mirëmbajtje dhe ndriçim në fshatra.
- Mbjellje pemësh në fshatrat Benç, Salari, Kodër, Hormovë.
- Pastrim dhe lyerje në shkolla.
- Mirëmbajtje e aseteve kulturore dhe infrastrukturore.

### **Diskutime.**

#### **Kryetari i fshatit Beçisht, z. Kalo Hoxha**

- Ndërhyrja në rrugën kryesore të fshatit, e cila është me shtresë asfaltike të dëmtuar.
- Ndërhyrje dhe rehabilitim i lerave.
- Ndërtimi ose rikonstruksioni i ujësjellësit të fshatit.

#### **Kryetari i Bashkisë, z. Gramos Sako**

Në përgjigje të kërkesës për rrugën e fshatit Beçisht, ndërhyrja është e planifikuar, por kërkon kohën e vet të zbatimit.

#### **Qytetari, z. Myzafer Liçi**

- U shpreh se përfaqëson pensionistët dhe kërkoi që të planifikohet një qendër sociale ku pensionistët e Tepelenës të mund të kalojnë kohën e lirë.
- Tregu i qytetit ka nevojë për ndërhyrje dhe sistemim.
- Propozoi të parashikohen investime për pallatet e banimit, për vendosjen e sistemit kapot

#### **Qytetari, z. Spartak Haska**

- Cfarë politikash dhe masash janë marrë nga bashkia për zhvillimin e bizneseve të agroturizmit në zonë.
- Kërkoi promovimin e produkteve të agroturizmit.
- Pyeti nëse ka plan për blerjen e pajisjeve të pastrimit për qytetin.

#### **Qytetari, z. Adriatik Zifla**

- Ndërtimi i një muzeu pranë Kalasë së Tepelenës.

**Z.Avni Lala;** Kërkoi të vlerësohet buxheti për emergjencat civile, veçanërisht për MZSH

**Aleksandër:** Për turizmin në Bashkinë Tepelenë, aktualisht mungon sinjalistika turistike. Kemi planifikuar vendosjen e sinjalistikës dhe jemi duke hartuar një plan që t'i shërbejë zhvillimit të turizmit, si dhe ndërtimin e një zyre "Info Point" pranë Agjencisë.

Për mjetin vetëpastrues, jemi duke aplikuar për sigurimin e tij dhe kjo çështje do të diskutohet më tej.

Kalaja e Tepelenës ndodhet në fazë transformimi; jemi duke diskutuar me një familje për ndërtimin e muzeut.

**Kryetari i Bashkisë Z.Gramos Sako:** Do të vendosen tabela orientuese te Ujëvara e Peshturës, si dhe tabela orientuese në rrugën hyrëse të Njësisë Administrative Kurvelesh.

**Aleksandër:** Pjesa e sinjalistikës do të zgjidhet.

**Kryetari i Bashkisë Z.Gramos Sako:** Shpresojmë në mbështetjen e donatorëve, pasi buxheti aktual nuk është i mjaftueshëm.

**Aleksandër:** Për pallatet, programi i sistemit "Kapoto" realizohet nga FSHZH dhe me fondet e Bashkisë, përmes aplikimit. Prioritet do të kenë pallatet 5-katëshe dhe ato në gjendje të amortizuar. Edhe këtë vit, me hapjen e thirrjeve, do të aplikojmë sipas prioriteteve.

**Mbajtëse e P/Verbalit Sekretare Këshillit**

**Valbona Çela**



**Koordinatorë Informimit Konsultimit Publik**

**Ela Skënderaj**

